Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0025

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Sodex Group SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Policia e Kosoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me paisje policore" me numër të prokurimit 214-23-11358-1-2-1, me 25/04/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Sodex Group SH.P.K. me nr. 2024/0025, e datës 08/01/2024, kurse vendimi i AK Policia e Kosoves lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me paisje policore" me numër të prokurimit 214-23-11358-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Konform nenit 31 par 6 i Rregullores së Punës së OSHP operatorit ekonomik ankues në ketë procedurë prokurimi, i kthehet tarifa e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datën 26.10.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me paisje policore" me numër të prokurimit 214-23-11358-1-2-1. Me datën 22.12.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 (Letër Standarde) për dhënie të kontratës ku është shpërblyer me kontratë (OE) “Pricom” SHPK.

Me datën 27.12.2023, Operatori Ekonomik “Sodex Group” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ne AK Policia e Kosovës.

Me datë 29.12.2023 Autoriteti Kontraktues, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 22.12.2023.

Me datën 05.01.2024, Operatori ekonomik "Sodex Group" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 0025/2024, kundër njoftimit për dhënie te kontratës të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

1. Pretendimet ankimore të OE ankues sipas ankesës Nr. 0025/24

Ne kemi kërkuar qasje ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate PRICOM SH.P.K., ku pas analizës qe i kemi pas dokumenteve te njëjtit dhe raportit te vlerësimit te tenderëve kemi vërtetuar se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm për arsyet si ne vijim: 1.OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit, ku kërkesë ka qene "Autorizim i lëshuar) nga prodhuesi / distributorit te autorizuar te prodhuesit (me titull dhe nr. Prokurimit te projektit ne fjale ne kohëzgjatje te kontratës) ", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Autorizim nga prodhuesi distributorit te autorizuar te prodhuesit për shitjen e produkteve për tenderin (me titull dhe nr. Prokurimit te projektit ne fjale ne kohëzgjatje te kontratës) ". Gjate analizës qe i kemi bere raportit te vlerësimit te tenderëve, kemi vërejtur qe AK-ja i ka kërkuar sqarime shtese OE te rekomanduar për kontrate dhe i njëjti ka prezantuar një autorizim te cilit i figuron data e leshimit pas datës se hapjes se tenderëve, pra autorizimi i prezantuar pas kërkesës për sqarime vetëm i është shtuar validiteti. Autorizimi i dorëzuar me sqarime mban datën 08.12.2023, kurse hapja e ofertave është bere me dt.30.11.2023. Autorizimi i prezantuar me këtë date përben ndryshim material ashtu siç përcaktohet ne dispozitat e nenit 59.4 te LPP-se.

Për me tepër neni 72.3 i LPP-se përcakton qarte: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do te aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e te cilave është e fiksuar, para skadimit te afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund te verifikohet ne mënyrë objektive. Ne këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se, sepse nuk është dashur te merret parasysh autorizimi i tille dhe ky OE është dashur te eliminohet nga konkurrenca. Gjithashtu kur analizohet autorizimi i prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, ne te njëjtin shënon qe kompania qe e ka lëshuar këtë autorizim është furnizues (Supplier) dhe jo prodhues, ashtu siç eshte kërkuar ne dosje te tenderit. OE i rekomanduar për kontrate është dashur te prezantoj ne oferte edhe autorizimin nga vete prodhuesi per kete furnizues, mirëpo AK-ja nuk i ka kërkuar nje gje te tille te njëjtit OE, andaj me këtë rast është favorizuar OE i rekomanduar për kontrate ne kundërshtim me nenin 7 dhe 72 te LPP-se.

2. Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër te dosjes se tenderit, ku eshte kërkuar "Prodhuesi duhet te jete i certifikuar me ISO Standarde te 9001-2015", ndërsa si dëshmi dokumentare eshte kërkuar "Kopje e certifikates me ISO Standarde te 9001-

2015. shenim me rendësi - Certifikatat duhet te posedojnë linkun e faqes për verifikim online te vatiditetit te certifikatave!". I njejti nuk e ploteson kerkesen e lartcekur per faktin se ne oferten e dorezuar ISO e prezantuar nuk e posedon linkun per verifikim dhe si e tille nuk mund dhe nuk eshte dashur te merret parasysh, per faktin se kerkesa per link ka qene kerkese obligative dhe e njejta eshte dashur te plotesohet nga OE i rekomanduar per kontrate. Perderisa i njejti OE nuk e ka prezantuar ISO certifikaten me link, atehere eshte dashur te eliminohet nga ana e autoritetit kontraktues dhe jo te rekomandohet per kontrate, pasi qe sice cekem me larte kerkesa e lartcekura eshte kerkese kualifikucse/obligative te cilen secili OE ofertues eshte dashur te prezantoj deshmi qe e permbush kerkesen e tille. Gjate qasjes ne dokumente dhe mostrat e OE te rekomanduar per kontrate, ne e keimi verejtur qe mostra (Pranga), e dorezuar nga i njejti OE nuk e posedon asnje shenje dalluese, e as emer te modelit dhe njekohesisht nuk e posedon as emrin e prodhuesit. Perderisa mostra e tille nuk i posedon asnjeren nga te dhenat te cilat i cekem me larte, ne dyshojme qe mostra (pranga) e prezantuar nuk eshte e prodhuesit per te cilin OE i rekomanduar per kontrate ka prezantuar autorizimet. Andaj kerkojme nga ana e OSIIP-se qe ti analizoj dhe verifikoj edhe nje here mostrat e prezantuara nga OE i rekomanduar per kontrate, pasi qe dyshimet tona jane te bazuara ne prova konkrete, sepse cdo produkt duhet te permbaje emrin e modelit apo prodhuesit, mirepo qe ne kete rast mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate nuk e posedon asnje shenje te tille dalluese. Ne kete rast autoriteti kontraktues nuk ka respektuar edhe nenin 52.7 te LPP-se.

Ne me dt.29.12.2023, kemi pranuar vendimin per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim, me arsyetimin se e njejta eshte e pa bazuar. Autoriteti kontraktues ne vendimin e saj per refuzim te kerkeses per rishqyrtim, vetem i ka pershkruar dispozitat ligjore per te cilat ne kemi parashtruar pretendime se te njejtat nuk jane respektuar, ku eshte munduar te arsyetohet duke thene se jane respektuar te gjitha dispozitat ligjore me rastin e vleresimit. Ne e kemi cekur se mostrat e dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate per Prangat, nuk posedojne emrin e prodhuesit, ndonje shenje dalluese apo emrin e modelit, ndersa AK-ja ne lidhje me kete pretendim e ka cekur se nuk eshte specifikuar decidivisht qe mostrat e dorezuara duhet te kane ndonje mbishkrim te prodhuesit, ndersa ka vazhduar duke thene se AK ju siguron se anetaret e vleresimit ne menyre profesionale i kane vleresuar mostrat dhe se ato kane permbushur specifikimet teknike, ndersa mostrat tjera te dorezuara posedojne shenjen e prodhuesit GK Profesional. Arsyetimi i autoritetit kontraktues eshte i pa bazuar dhe i paqendrueshem sidomos kur kemi parasysh se te gjitha produktet e nje prodhuesi posedojne emrin e tij, ose shenjat dalluese apo edhe emrin e modelit, mirepo tek ky produkt nuk figuron asnje e dhene, atehere dyshimet tona faktikisht po vertetohen se ky produkt nuk eshte nga prodhuesi per te cilin OE i rekomanduar per kontrate ka prezantuar autorizimin. Pra autoriteti kontraktues ka bere shmangie nga pretendimi yne ankimor pasi qe nuk ka dhene arsyetime konkrete per te deshmuar te kundeiten e pretendimit tone ankimor, por vetem e ka cekur se nuk eshte specifikuar nje gje e tille.

Autoriteti kontraktues ne pergjigje nder te tjera ka thene se per mostrat per pranga nuk eshte kerkuar qe te posedoje emrin e prodhuesit, kurse per mostrat tjera eshte pergjigjur se posedojne shenjen e prodhuesit GK Profesional.

Me kete pergjigje vete autoriteti kontraktues e pranon se oferta e OE te rekomanduar per kontrate ka mangesi, mirepo i shmanget kesaj mangesie duke u pergjigjur per mostrat e tjera. Po ashtu per mostrat tjera kur ka dhene pergjigje i ka bashkangjitur edhe fotot e ketyre mostrave qe e permbajne emrin e prodhuesit por nuk ka bashkengjit foto per mostrat per pranga, e per te cilat ne kemi ngrit pretendime ankimore dhe per te cilat qarte shihet se nuk permbajne asnje te dhene te prodhuesit. Me poshte jane fotot te cilat ne po i kontestojine. Nga keto foto shihet qarte se

mostra per pranga nuk permban asnje te dhene te prodhuesit, prandaj ketu shihet arsyetimi favorizues i AK-se, ku ne njeren ane per disa mostra e cek qe kane te dhena te prodhuesit, ndersa per mostrat per pranga thote se nuk jane kerkuar. Pra AK-se perdor standarde te dyfishta ne pergjigje dhe ne vleresim te ofertave. Ne lidhje me pretendimin tjeter ku e kemi cekur se OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar kerkesen ne lidhje me ISO standardin 9001-2015, pasi qe ne kerkese eshte specifikuar decidivisht se Certifikatat e prezantuara duhet te posedojne linkun per verifikim online, autoriteti kontraktues edhe kete pretendim tonin e ka cilesuar si te pa bazuar. E njejta ne vendimin e saj e ka cekur se AK-ja e ka verifikuar kete standard permes kodit qe gjendet ne standardin e dorezuar. Arsyetimi i autoritetit kontraktues eshte i paqendrueshem, per faktin se kerkesa e dosjes se tenderit ka qene shume e qarte se certifikatat duhet te posedojne linkun per verifikim, andaj perderisa ne certifikaten e prezantuar nga ky OE nuk figuron nje link i tille i njejti duhet te eliminohet sepse nuk ka ofertuar konform kerkeses se dosjes se tenderit. Autoriteti kontraktues po e favorizon OE te rekomanduar per kontrate, per faktin se tani nuk po i referohet kerkeses ku eshte specifikuar decidivisht kerkesa ne lidhje me linkun. Neni 59.4 e percakton qarte kur nje tender konsiderohet i pergjegjshem dhe ate si ne vijim "Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit ". Me keto mangesi te deshmive te OE te rekomanduar per kontrate rezulton se tenderi i ketij OE nuk eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. Ne lidhje me pretendimin tone sa i perket autorizimit te prezantuar me sqarime shtesw nga OE i rekomanduar per kontrate pas dates se hapjes se ofertave, AK-ja e a cekur se ka kerkuar sqarim dhe ka pranuar pergjigjjen nga prodhuesi rreth kohezgjatjes se autorizimit dhe nuk konsiderohet ndryshim material pasi qe eshte vetem nje konfirmim nga prodhuesi per mbeshtetje te OE gjate kohezgjatjes se kontrates. Vet autoriteti kontraktues po e pranon se eshte bere nje autorizim i ri pasi qe i vjetri nuk ka pasur validitet sipas kerkeses se dosjes se tenderit, andaj ky fakt tregon qarte se autorizimi i prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate gjate sqarimeve eshte dokument i cili perben ndryshim material dhe substancial, sepse data i figuron pas dates se hapjes se ofertave. Pra ne kete rast nuk jane respektuar dispozilat e nenit 59 dhe 72.3 te LPP-se, dhe me kete veprim autoriteti kontraktues perseri po mundohet ne cdo menyre te favorizoj OE te rekomanduar per kontrate, ku i njejti edhe pse eshte i papergjegjshem po rekomandohet per kontrate. Fakti i mungeses se validitetit te autorizimit perben ndryshim substancial edhe per faktin se mund te kete operator ekonomik qe nuk kane ofertuar fare per shkak se autorizimi ka qene pa validitet, ndersa nese merret parasysh tani autorizimi i ri me validitet i OE te rekomanduar per kontrate perben favorizim te hapur per kete OE, ndersa diskriminim per operatoret tjere ekonomik dhe ky veprim bie ndesh me nenin 7 te LPP-se. Ndersa ne lidhje me pretendimin tone se autorizimi i leshuar per OE te rekomanduar per kontrate eshte i leshuar nga nje furnizues ashtu sic eshte specifikuar ne autorizim dhe jo nga nje prodhues sip eshte percaktuar ne dosje te tenderit, autoriteti kontraktues edhe ne kete rast pretendimin tone ankimor e ka cilesuar si te pa bazuar. Autoriteti kontraktues sa i perket ketij pretendimi e ka cekur se ka bere disa hulumtime dhe ne web faqen e tyre figuron si prodhues dhe cdo produkt i prezantuar tek AK jane te prodhuesit GK. Ky arsyetim i AK-se eshte i pa bazuar dhe i paqendrueshem per faktin se nga vet autorizimi i prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate shkruan se i njejti eshte furnizues dhe jo prodhues. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka dhene asnje deshmi per web faqen e kesaj kompanie dhe ky fakt tregon qarte se arsyetimi i AK-se eshte i paqendrueshem. Duke u bazuar ne te gjitha faktet e lartcekura kuptohet qarte se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem, pasi qe nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe specifikimeve teknike dhe si i tille eshte dashur te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit. Duke u bazuar ne deshmite dhe faktet qe u ceken me larte, rezulton se

ekzaminimi vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se dhe njekohesisht nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates, e qe ka qene tenderi i pergjegjshem me cimim me te ulet sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-se. Neni 72 i LPP-se eshte perdor ne menyre favorizuese ne raport me OE e rekomanduar per kontrate. Nuk eshte respektuar edhe neni 7 i LPP-se, sepse nuk jane trajtuar te gjithe operatoret ekonomik njejte por eshte favorizuar OE i rekomanduar per kontrate, ndersa paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente, mirepo ju nuk i jeni permbajtur as kesaj dispozite ligjore. Gjithashtu paragrafi 6 i kesaj dispozite, pika (vi) shkruan qarte citojme "qe tenderi i zgjedhur te perputhet me te gjitha aspektet permbajtjesore te kushteve, kritereve dhe specifikimeve perkatese". Ndersa ne kete rast OE i rekomanduar per kontrate eshte i pergjegjshem dhe oferta e tij nuk perputhet me kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

2. Përgjigjet e AK në pretendimet e OE në kërkesën për rishqyrtim

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 1 Qëllimi-Qëllimi i aktivitetit është marrja e fumizimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publikuesi dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Oferta e juaj është e ofertë e përgjegjshme me çmimin me të lartë se OE i rekomanduar për kontratë. ky pretendim është e pa bazuar. AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se Autoriteti kontraktues i ka trajtuar te gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe ka vepruar në mënyrë transparente, ku të gjithë Operatoret Ekonomik pjesëmarrës ne ketë aktiviteti i ka trajtuar të barabartë. Po ashtu AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, AK ka vepruar ne harmoni me LPP-ne që tenderi i zgjedhur te përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse pasi që oferta e rekomanduar për kontrate i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Andaj, Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ky pretendimi është i pa bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Nenin 52 i LPP-se sipas pretendimit te OE se mostrat e dorëzuar nuk posedojnë emrin e prodhuesit AK sqaron se nuk është e specifikuar decidivisht qe mostrat e dorëzuar duhet te kenë ndonjë mbishkrim te prodhuesit, AK ju siguron se anëtarët e vlerësimit ne mënyre profesionale e ka vlerësuar mostrat dhe ka përmbush specifikat e detyrueshme ndërsa mostrat e tjera te dorëzuar posedojmë shenjen e prodhuesit GK Profesional, me poshtë gjeni fotot ky pretendim është e pa bazuare.

AK ka shkelur nenin 59 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK ka vlerësuar mbi bazën e kritereve te kërkuara ne DT dhe njoftimit për kontrate dhe mbi bazën e mostrave te dorëzuar nga OE pjesëmarrës dhe ka vlerësuar ne harmoni te plote me kritereve te përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate dhe është rekomanduar për kontratë OE i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njëkohësisht është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. ky pretendim është e pa bazuare.

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ne harmoni te plote me kritereve te përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate dhe është rekomanduar për kontratë OE i cili i ka plotësuar të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njëkohësisht është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët Oferta e juaj është me çmim me të lart se oferta e rekomanduar për kontratë ky pretendim është e pa bazuar.

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që ka vlerësuar mbi baze te kritereve te kërkuar ne njoftimin për kontrate dhe DT dhe ka vlerësuar mbi baze te mostrave te dorëzuar, ndërsa sa përket pretendimit se Certifikata ISO 9001-2015 nuk e ka linkun ne Certifikatën e dorëzuare dorëzuar AK ka verifikuar ketë standard përmes kodit i cili gjendët ne standardin e dorëzuar. ky pretendim është e pa bazuare.

AK ka shkelur nenin 72 te LPP-ës dhe Neni 38 i Rregullores Nr.001/2023 për prokurim publik. nuk qëndron pasi AK ka kërkuar sqarimi i nga prodhuesi,AK ka pranuar përgjigje nga prodhuesi rreth kohëzgjatjes se autorizimit dhe nuk konsiderohet ndryshim materialit pasi qe vetëm një konfirmim nga prodhuesi për mbështetje te OE gjate kohëzgjatjes se kontratës.

Sa përket pretendimit se GK Profesional nuk është prodhues por është vetëm furnizues AK sqaron OE te lista e çmimeve emri prodhuesit dhe vendi i origjinës është specifikuar si prodhues GK profesional se pas disa hulumtimeve ne web faqen e GK profesional ky ekziston si prodhues dhe çdo produkt i prezantuar tek AK janë te prodhuesit GK Profesioan, ky pretendim është e pa bazuar.

Lidhur me këtë, me 01/02/2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Vendimi i AK-se për dhënie të kontratës, të anulohet ndërsa lënda të kthehet në ri-vlerësim

3. Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Sa i përket pretendimit lidhur me autorizimin e prodhuesit qe kompania ankuese e ka cekur eksperti konstaton se kompania e rekomanduar për kontrate ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit me datën 10.11.2023 ndërsa hapja e ofertave ka qene 30.11.2023, mirëpo ne këtë autorizim nuk ceket me kohëzgjatje te kontratës siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues i Policisë se Kosovës.We GK PROFESSIONAL, who are official supplier of Handcuffs and Batons, headquartered at [159 Avenue Gallieni, 93177 Bagnolet, FRANCE, do hereby authorize Pricom sh.p.k to submit a bid the purpose of which is to provide the Goods, supplied by us, and to subsequently negotiate and sign the Contract. Shih kriterin e DT: e)Autorizim nga prodhuesi distributorit të autorizuar të prodhuesit për shitjen e produkteve për tenderin (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë

në kohëzgjatje te kontratës).

Autoriteti Kontraktues i Policisë se Kosovës ka kërkuar sqarim lidhur konfirmimin e kohe zgjatjes se autorizimit nga kompania "GK PROFESIONAL " France me datën 07.12.2023 qe nuk është i cekur sa është afati i tenderit ne autorizim. Kompania "GK Profesional" është përgjigjur dhe ka cekur ne autorizim se ka valiiditet 12 muaj siç ka qene kërkesa e dosjes se tenderit.

WHEREAS We GK PROFESSIONAL, who are official supplier of Handcuffs and Batons, headquartered at [159 Avenue Gallieni, 93177 Bagnolet, FRANCE, do hereby authorize Pricom sh.p.k to submit a bid the purpose of which is to provide the Goods, supplied by us, and to subsequently negotiate and sign the Contract. The auhorization is valid for the whole execution of the contract for 12 months.

AK Policia e Kosovës kur ka kërkuar sqarim për autorizim konstatoj si ekspert se pyetja qe ju është drejtuar ka kërkuar konfirmimin e kohëzgjatjes te autorizimit pasi ne autorizimin e dorëzuar nuk ka qene i përcaktuar. Autorizimin qe ka dorëzuar kompania e rekomanduar per kontrate eksperti mundet te konkludoj se autorizimi është lëshuar për këtë aktivitet te prokurimit me numër te prokurimit qe i bije se për këtë aktivitet sa është e përcaktuar sasia ka autorizim qe i bie se për atë sasi është autorizuar kompania e rekomanduar për kontrate. Ndërsa sa i përket se nuk është e cekur vlefshmëria ne autorizim 12 muaj kjo mundet te konsiderohet si devijim i vogël pasi autorizimi është lëshuar për aktivitet te prokurimit dhe për ekspertin shqyrtues AK-ja Policia e Kosovës nuk është dashur te beje sqarime lidhur për këtë pike te autorizimit pasi autorizimet lëshohen për aktivitet te prokurimit.

Sa i përket autorizimit qe është dorëzuar pas sqarimit te kërkuar nga AK-ja me datën 12. 08. 2023 ne këtë autorizim ceket vetëm vlefshmëria qe është kërkuar per 12 muaj qe është përgjigjur sqarimit te AK-se Policisë se Kosovës se pjesa tjetër e autorizimit është sipas autorizimit qe është ne oferte, ky Autorizim është për sqarim te vlefshmërisë qe nuk është ndryshim material. Lind pyetja se a ka pas drejt AK-ja kur ka sqaruar vlefshmërinë e autorizimit unë si ekspert mendoj qe nuk ka pas arsye me kërkuar sqarim pasi autorizimi është lëshuar për aktivitet te prokurimit per komplet sasinë sa është kërkuar ne dosjen e tenderit. Pretendimi i OE ankues "Sodex Group SH.P.K, se autorizimi nuk është lëshuar nga prodhuesi por është i lëshuar nga Furnizuesi, autorizimi është i lëshuar nga furnizuesi mirëpo kërkesa e dosjes se tenderit ka qene duhet te dorëzohet autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i prodhuesit, pra ne kete rast distributor mundet te jete furnizues .Shih kërkesën e) Autorizim i lëshuar) nga prodhuesi / distributorit të autorizuar të prodhuesit (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë në kohëzgjatje te kontratës).

Ndërsa sa i përket se a ka drejt "GK PROFESSIONAL" si distributor për lëshimin e autorizimin mendoj se komisioni i vlerësimit i AK-se Policia e Kosovës është dashur te beje sqarime lidhur për këtë kërkesë te dosjes se a ka pas te drejtën me lëshuar autorizime kompania "GK PROFESSIONAL". AK-ja duhet te beje sqarimin lidhur me te drejte se a ka pas drejt si distributor te lëshoj autorizimet kompania "GK PROFESIONAL". Pretendimi ankimor konstatoj se është pjesërisht i bazuar.

Konstatimi i dytë: Sa i përket pretendimit lidhur me Certifikaten ISO Standarde te 9001-2015 qe OE i rekomanduar nuk e ka linkun per verifikim sic ka qene ne dosjen e tenderit , une mendoj si eksperte, se pari ka qene kërkesa e dosjes e kerkuar gabim pasi kompanit e akridtuar si "SGS" per certifikatat e standardeve kane modelet/dizajnet e certifikatave standard qe i leshojne per

kompani qe i kërkojnë. Duke u bazuar ne kete mendoj si ekspert se keto kompani nuk i ndryshojne certifikata sipas kërkesave te AK-se qe te jete edhe linku per verifikim e certifikates, ne certifikata ISO është numri serik/akredituar. Se dyti kjo certifikat eshte leshuar ne korrik 2023 dhe eshte lëshuar për kompaninë GK Profesional qe ka afat deri 2026 qe i bije qe eshte document qe eshte lëshuar para njoftimit per kontrate dhe AK-ja munden me ja kerkuar OE cdo document qe eshte i lëshuar pra njoftimit per kontrat, mirpo kete certifikat konstatoj se AK-ja e ka sqaruar/verifikim certifikatën. Nese AK-ja ka pasur dyshime ne baze te nenit 59 ka mundur te kerkoj sqarime per keto dokumenta gjithashtu edhe ne baze te nenit 72 te LPP-se ka mundur ti kerkoj keto dokumenta pasi jane te leshuar para publikimit te njoftimit per kontrata. Eksperti konstaton se i ka verifikuar AK-ja Policia e Kosovës dhe pretendimi është i pa bazuar. Neni 10 i Udhëzuesit për prokurim publik karte parasheh situatat kur AK, duhet te kërkoj sqarim shtese nga tenderuesi - kandidati.

Konstatimi i tretë: Eksperti shqyrtues konstaton se ne dosjen e tenderit nuk janë kërkuar qe mostrat te kenë emrin e prodhuesit as emrin e modelit, (b) OE duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull ne ditën e hapjes para orës 14:00h) gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë "Pricom shpk" ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit dhe ka nënshkruar deklaratën se do te qëndroj pas ofertës qe ka ofertuar. Ne përshkrimin e çmimit e ka cekur emrin e prodhuesit dhe origjinën e prodhuesit qe përputhet me autorizim kështu qe AK-ja gjate fazës se realizimit te kontratës duhet te behet pranimi i mallit sic ka qitur ne oferte pra Origjina nga Franca prodhuesi GK Profesional kështu qe është përgjegjësi e AK-se. E sa i përket pse nenit 52.7 qe OE ankues ju ka referuar ne këtë rast AK ka vërtetuar dokumentet qe ka pasur dyshime siç është autorizimi për validitet, certifikatën ISO ndërsa për mostra nuk ka dyshime dhe nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit kështu qe për ekspertin shqyrtues nuk kane pasur te drejt Ak-ja te kërkon sqarim ose ta eliminon kompaninë "Pricom" qe ne mostra nuk ka emër te prodhuesit per ekspertin shqyrtues ky pretendim është i pa bazuar derisa nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit.

Konstatimi i katërt: Sa i përket nenit 7 diskriminimit mendoj se është vlerësuar oferta e OE ankues ne përputhje me nenin 59 te LPP-se qe është cilësuar si OE i pasuksesshëm me çmim me te larte dhe nuk është bere një diskriminim i qëllimisht nga AK-ja këtij OE ankues.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në kontest me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj

fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i Shqyrtimeve, i ka trajtuar në mënyrë profesionale objektive dhe pretendimet e Operatorit Ekonomik, raporti është paraprakisht një ekspert që në dokumentet përkatëse i referohen aktiviteteve të prokurimit. Konstatimet në raportin e mundshëm të konfirmohen nga dosjet e tenderit si dhe dokumentet e tyre të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë të raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendon ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të tillë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe rekomandimeve të provave, konstatimit të ligjshëm të gjendjes faktike, duke u bërë materiale në LPP si zbatueshëm, pas disa pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndëve dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit duhet të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Rrjedhim, Paneli Shqyrtues konsideron se si ekspertit dhe aktet e AK, dhe mendimet e shqyrtimeve lidhur me lidhjen jo të plotë të kushteve që janë parë si më sipër dhe pohimet ankimore në këto raste të veçanta janë që aktivitetet e prokurimit të kthehen në rivlerësim. AK me rastin e ri-vlerësimit të veproj konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në faktin e aprovimit të ankesave të OE, vendosi të kthehet në tarifën e ankesës në shumën e tyre dhe të deponuar nga operatorët ekonomik ankues të lidhur në nenin 31 par. 4, lidhur me me par 6 të Rregulloreve të Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP-së, se Autoritet kontraktuese ushtrojnë funksionin e tyre në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe të tjerat e akuzuara për organin e pretendimeve të ankimuara dhe të ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të qëndruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar “Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për përmirësimin dhe krahasimin e Komisionit Vlerësues marrin pjesë në kryerjen e veprimeve individuale.

Paneli Shqyrtues ka vend në me kompetencat juridike në kuptimin e 104 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 të LPP-së për veprimet e procedurave të gjykimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllimet e zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndëve. Prandaj Paneli Shqyrtues i konstatimit të bazës së tij në dispozitat përkatëse të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situatën e tillë, që mund të shfaqen gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur në dispozitiv të vendimit.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Sodex Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: